VENDIM
Nr. 542, datë 19.9.2018

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË FALIMENTIMIT

(ndryshuar me VKM nr. 294, datë 17.5.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 202, të ligjit nr. 110/2016, "Për falimentimin", dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia Kombëtare e Falimentimit, më poshtë "Agjencia", është person juridik publik, në varësi të ministrit të Drejtësisë.

2. Agjencia ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema e Agjencisë përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë dhe ka shënimet "Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Agjencia Kombëtare e Falimentimit", në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë, si dhe raportin e përmasave të saj", të ndryshuar.

Vula e Agjencisë ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare". Vulat prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Agjencia ka si mision sigurimin dhe përdorimin e mjeteve efikase për të ruajtur ligjshmërinë e procedurave të falimentimit, duke mbikëqyrur aktivitetin e administratorëve të falimentimit.

4. Agjencia, për të realizuar misionin e përcaktuar në pikën 3, të këtij vendimi, kryen funksione administrative dhe detyrat e mëposhtme:

a) Siguron zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator që është efikas dhe eficient në fushën e falimentimit;

b) Zhvillon ndërgjegjësimin në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e të gjithë aktorëve të përfshirë në fushën e falimentimit;

c) Mbikëqyr dhe drejton procesin e falimentimit duke inkurajuar zbatimin eficient e të shpejtë në përputhje me ligjin;

ç) Kthimin e Agjencisë në institucionin e vetëm publik informues për çështjet e falimentimit në Shqipëri.

5. Agjencia përmbush objektivat, kryen detyrat dhe ushtron përgjegjësitë, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 110/2016, "Për falimentimin".

6. Agjencia drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori i Agjencisë, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e Agjencisë dhe i raporton ministrit të Drejtësisë.

7. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

8. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Agjencisë miratohet nga ministri i Drejtësisë, pas propozimit të drejtorit të Agjencisë.

9. Marrëdhëniet e punës së drejtorit dhe të nëpunësve të Agjencisë rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

10. Në rastin e mbylljes dhe të ristrukturimit të institucionit, për nëpunësit civilë aktualë të

Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil.

11. Për realizimin e detyrave, Agjencia ka buxhetin e saj, si zë i veçantë në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë.

12. Buxheti krijohet dhe përdoret sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit financiar dhe buxhetor. Të gjitha donacionet ose të ardhurat e tjera të ligjshme përdoren sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit financiar dhe buxhetor.

13. Agjencia mban dhe përditëson në formë shkresore dhe elektronike, regjistrin e administratorëve të certifikuar të falimentimit. Formati dhe përmbajtja e regjistrit përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Agjencisë.

14. Agjencia, nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë, organizon dhe zhvillon provimin për administratorët e falimentimit.

15. Agjencia ka të drejtë të mbikëqyrë dhe të kontrollojë, periodikisht, në çdo kohë, subjektet e licencuara prej saj, si dhe të kërkojë të verifikojë çdo informacion, të cilin e konsideron të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të ngarkuara me ligj. Rregulla më të hollësishme për procedurat e mbikëqyrjes dhe të kontrollit miratohen nga ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Agjencisë.

16. Numri i punonjësve dhe fondet e miratuara për Agjencinë e Mbikëqyrjes së Falimentimit i kalojnë Agjencisë, sipas këtij vendimi.

17. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të Agjencisë Kombëtare të Falimentimit, sipas këtij vendimi, Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentimit të vazhdojë funksionimin e saj, sipas strukturës dhe organikës që është aktualisht në fuqi.

18. Vendimi nr. 852, datë 21.10.2010, i Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentimit", shfuqizohet.

19. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Falimentimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama